



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**

Numri i lëndës: 2024:038090

Datë: 19.04.2024

Numri i dokumentit: 05597995

**C.nr. 08/2024**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil,** në procedurë jo kontestimore, me gjyqtarin Genc Hasani, duke vendosur lidhur me propozimin e propozuesit F. H. nga Komuna e P. lidhur me propozim për konfirmim të vdekjes për Q. H. me vendbanim të fundit në M. pas mbajtjes së seancës kryesore me datën 15.04.2024 me pjesëmarrjen e propozuesit, jashtë seance me datë 19.04.2024 nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. APROVOHET** Propozimi i propozuesit F. H. si i bazuar. **KONSTATOHET** se Q. H. ka lindur me dt. ... ne fshatin Z., Komuna e Mi., nga i ati H. dhe nena H., ndërsa ka vdekur ne vitin ...

**II.** Aktvendimi i dërgohet Zyrës së Gjendjes Civile në Mitrovicë për regjistrimin e faktit të vdekjes në regjistrat përkatës, pasi qe aktvendimi është i formës së prerë nga data ....

**A r s y e t i m**

Propozuesi F. H., me datë ..., ka ushtruar propozim në gjykatë, për konstatimin e faktit të vdekjes së babait të tij Q. H. nga fshati Z. Komuna e M. i cili ka lindur në vitin ... në fshatin Z. Komuna e M. dhe ka vdekur në vitin ...

Gjykata në bazë të nenit 7 të LPK-së, në seancë kryesore me datë ... i administroj të gjitha provat, dhe atë dëgjimin e propozuesit në cilësi te palës F. H., ekstrakti i lindjes se propozuesit, vërtetimi i lëshuar nga Sektori i Gjendjes Civile në Komunën e Mitrovicës, i cili dëshmon se babai i propozuesit Q. H. nuk është i regjistruar në regjistrat e gjendjes civile, Fotografia e varrit të Q. H., ku dëshmohet viti i lindjes ... dhe viti i vdekjes 1..., Vendimi nr.P.br. ... i datës ..., me të cilin dëshmohet se Q. H., ka qenë i martuar me M. H. e vajzërisë Islami dhe i njëjti ka vdekur në vitin ..., Ekstrakti mbi regjistrimin e martesës, i datës ..., me të cilin dëshmohet se Q. H., ka qenë i martuar me M. H., e vajzërisë I. Dëgjimi i propozuesit dhe Vendimi nr.P.br ... i datës ...

Nga të gjitha provat të cilat janë administruar në shqyrtim kryesor si dhe nga deklarimi i propozuesit vërtetohet se i ndjeri Q.H. ka lindur në vitin 1893 dhe ka vdekur në vitin ... Lidhur me ditën dhe muajin e lindjes Gjykata, pasi që nuk ka pasur datën e sakte por vetëm vitin në të cilin ka lindur Q. H., atëherë mori për bazë datën e pare të muajit Janar të vitit .. ndërsa lidhur me ditën dhe muajin e vdekjes së Q. H, gjykata mori për bazë të njëjtin fakt sikur se tek lindja e të njëjtit.

Në rastin konkret pasi që vdekja e Q. H nuk mund të provohet me asnjë dokument që parasheh ligji për shkak të rrethanave të sqaruara më lartë gjykata i zbatoj dispozitat e nenit 73 të LPJK ku është përcaktuar *“Në qoftë se vdekja faktike e një personi nuk mund të provohet me anë të dokumentit të parashikuar me ligjin për librat amzë, çdo person që ka interes juridik të drejtpërdrejtë dhe organi i kujdestarisë mund t’i paraqesin propozim gjykatës që me aktvendim të konstatojë vdekjen të këtij personi.”*

Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar si rezultat i provave të administruara gjykata erdhi në përfundim se propozimi i propozuesit është i bazuar, prandaj në përputhshmëri me dispozitat ligjore të cituara më lartë dhe dispozitat e nenit 17 të LPJK nr.03/L-007 vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË,  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
CN.nr. 08/2024, me datë. 19.04.2024**

**Gjyqtari,  
Genc Hasani**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Ndaj këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të të njëjti. Ankese paraqitet pranë kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.